



**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË**  
**AFATET E ANKIMIMIT**

**Drejtuar:**

**OE “4 A-M” sh.p.k.**

**me NIPT K92005016L**

Tiranë, Rruga “Artan Lenja”, Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-rë

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO**  **JO**

**Tipi i Kontratës:** Punë.

**Lloji i procedurës së prokurimit:** E hapur – me mjete elektronike.

**Numri i referencës së procedures:** REF-80393-03-30-2026.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Punime primare, furnizim dhe vendosje e një autotransformatori të ri trefazor 220/110 kV, 150 MVA, punime sekondare për përshtatjen e tij me sistemet ekzistuese në nënstacionin Hoxhare”.

**Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:** Datë 31.03.2026.

**Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike:** Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 24, datë 07.04.2026.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

**1. OE “RAFIN COMPANY” sh.p.k.**

**me NIPT L52125110A**

Vlera 246,000,000 (dyqind e dyzet e gjashtë milion) Lekë pa TVSH.

**OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

**2. OE “4 A-M” sh.p.k.**

**me NIPT K92005016L**

Vlera 294,500,000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.

**OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. OE “RAFIN COMPANY” sh.p.k., me NIPT L52125110A, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur asnjë punë të ngjashme në nivel tensioni  $\geq 220$  kV. Kontratat e paraqitura nga OE ofertues janë në nivel tensioni deri 110 kV, të cilat janë ndryshim të ndryshme nga ato objekt procedure prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori të autorizuar për “Variatorin e ndryshimit të degëzimeve në ngarkesë”, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.10, pasi autotransformatori objekt procedure prokurimi nuk përputhet me specifikimet teknike të paraqitura në katalogun e OE ofertues. Konkretisht, OE ofertues, për përmbushjen e këtij kriteri, ka paraqitur dokumentin me emërtimin “Dok\_teknike\_1”, në të cilin pasqyrohen të dhënat teknike të autotransformatorit të kërkuar. Nga të dhënat e paraqitura rezulton se prodhuesi “...” prodhon autotransformator fuqie mbi 72.5 kV, por pa specifikuar nëse arrin në kapacitetin e kërkuar nga AK prej 220 kV. Për të vërtetuar këto të dhëna, AK verifikoi të dhënat e paraqitura nga faqja zyrtare e prodhuesit, nga ku rezulton në linkun: [...](#), se prodhuesi “...” mund të prodhojë Transformatorët e fuqisë me vaj deri në 100 MVA dhe 170 kV, ndërkohë që autotransformatori objekt prokurimi i kërkuar nga AK duhet të jetë në fuqinë 150 MVA dhe nivelin e tensionit 220 kV.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “4 A-M” sh.p.k., me NIPT K92005016L**, Adresa: Tiranë, Rruga “Artan Lenja”, Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-rë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **294,500,000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.